



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i monitorimit të zbatimit të projekteve
përfituese të Organizatave të Shoqërisë Civile, 2024
në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar

Korrik, 2025

Tabela e përmbajtjes

I.	HYRJE	4
	Qëllimi i raportit	4
	Përmbledhje e pëgjithshme	4
II.	METODOLOGJIA E MONITORIMIT	5
III.	PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE TË MBËSHTETURA	5
	Fushat kryesore të projektit	5
IV.	NDIKIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK ...	9
	Rritja e kapaciteteve profesionale dhe ekonomike	9
	Fuqizimi i komuniteteve dhe përfshirja sociale	10
	Zhvillimi i kapaciteteve lokale dhe bashkëpunimi rajonal	10
	Efektet afatgjata dhe rekomandimet	10
V.	REKOMANDIME	10
VI.	ANEKS.....	Error! Bookmark not defined.



Lista e tabelave

Tabela 1.: OJQ-të të cilat nuk i kanë realizuar aktivitetet e parapara në projektet e mbështetura	4
Tabela 2.: Të dhënat rreth projekteve të mbështetura.....	5

Lista e figurave

Figura 1.: Shpërndarja e OSHC-ve përfituese sipas rajoneve zhvillimore	9
--	---

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonaj
DZHR	Departamenti për Zhvillim Rajonal
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
OJQ	Organizata Jo Qeveritare



I. HYRJE

Qëllimi i raportit

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të detajuar mbi zbatimin e projekteve të mbështetura financiarisht nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) në kuadër të Thirrjes Publike për vitin 2024, e cila mbështeti Organizatat e Shoqërisë Civile (OJQ) në avancimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë. Raporti synon të vlerësojë progresin e realizimit të aktiviteteve, të evidentojë sfidat e hasura gjatë implementimit dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e proceseve të ardhshme.

Përmbledhje e përgjithshme

Në vitin 2024, MZHR ndau mbi 244,700 euro për 61 OJQ që realizuan 57 projekte në gjashtë rajone zhvillimore të Kosovës. Projektet kishin fokus përmirësimin e kushteve ekonomike, fuqizimin e grupeve të marginalizuara dhe rritjen e kapaciteteve lokale. Monitorimi u realizua përmes vizitave në terren, analizës së dokumentacionit dhe intervistave me përfituesit dhe zbatuesit.

Nga 61 përfitues, katër prej tyre nuk kanë realizuar aktivitetet e planifikuara. Në një rast (OJQ GURMANIA) mjetet janë kthyer në llogarinë kryesore të buxhetit të Republikës së Kosovës ndërsa për tre rastet tjera (OJQ Center za mir i toleranciju – CMTP, OJQ Handikos – Lipjan dhe OJQ IFYF), MZHR, me kërkesë të Zyrtarëve Monitorues, ka iniciuar procedurat për kthimin e mjeteve financiare përmes mekanizmave ligjor të parashikuar për shkelje të kushteve të financimit.

Tabela 1.: OJQ-të të cilat nuk i kanë realizuar aktivitetet e parapara në projektet e mbështetura

Emri i OJQ-së	Titulli i projektit	Qyteti	Rajoni zhvillimor	Σ e ndarë nga MZHR
Center za mir i toleranciju - CMTP		Graçanicë	Qendër	4,010.00
Handikos - Lipjan		Lipjan	Qendër	3,800.00
IFYF		Fushë Kosovë	Qendër	2,010.00
GURMANIA		Fushë Kosovë / Obiliq	Qendër	4,010.00
Gjithsej:				13,830.00

(Burimi: DPKZHR – MZHR)



II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi u bazua në standardet e MZHR për transparencë dhe llogaridhënie dhe përfshiu metodat kryesore:

- Vizita në terren për secilin projekt;
- Vlerësim i dokumentacionit financiar dhe narrativ të OJQ-ve;
- Intervista me përfituesit dhe zbatuesit;
- Analizë krahasuese ndërmjet objektivave dhe rezultateve të arritura.

Për mbikëqyrjen e 61 projekteve u angazhuan dy monitorues:

1. Gresa Gashi dhe
2. Hashim Ibishi,

të cilët realizuan vizita të paktën në një aktivitet të secilit projekt dhe mbajtën komunikim të vazhdueshëm me udhëheqësit e projekteve.

III. PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE TË MBËSHTETURA

MZHR mbështeti 61 OJQ në realizimin e projekteve të ndryshme në gjashtë nga shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës (Qendër, Jug, Veri, Lindje, Perëndim, Jug-lindje), duke shpërndarë një fond total prej 244,700 euro.

Fushat kryesore të projektit

- Fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe punësimi i të rinjve;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë;
- Promovimi i barazisë gjinore;
- Përmirësimi i kapaciteteve lokale dhe rajonale;
- Përkrahja e grupeve të marginalizuara si komunitetet ashkali, rome, egjiptianë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Tabela 2.: Të dhënat rreth projekteve të mbështetura

Emri i OJQ-së	Titulli i projektit	Qyteti	Rajoni zhvillimor	Σ e ndarë nga MZHR
Sakuntala	Ngritje e kapaciteteve profesionale dhe e punësimit të të rinjve të komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian	Prizren	Jug	2,100.00
Shoqata e Mediave Turke të Kosovës SHMTK	Jam e zonja në shumë fusha - Her tezgahatë bezim var	Prizren	Jug	2,100.00



Kosova Turkiye Mezunlari Derneği - TUMED	Sosyo Ekonomik Kaldinma için Eğitimler - Trajnimet për zhvillim socio-ekonomik	Prizren	Jug	2,100.00
AZHR Jug	Promovimi i Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar përmes zhvillimit të kapaciteteve rajonale për aplikim në skema të granteve për OJQ dhe biznese	Prizren	Jug	6,010.00
Women World Today and Now	Zhvillimi dhe avancimi socio-ekonomik	Prishtinë / Lipjan	Qendër	4,010.00
Retina	Identifikim i mundësive të bashkëpunimit në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal	Lipjan	Qendër	4,010.00
Instituti Optimun	Ngritja e kapaciteteve të rinisë me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik dhe social	Obiliq	Qendër	4,010.00
Agjencia për Zhvillim Rajonal Veri - AZHR	Zhvillimi i qëndrueshëm përmes iniciativës strategjike për zhvillim rajonal	Mitrovicë	Veri	6,010.00
North Youth Movement - NYM	Hulumtimi i mundësive për bashkëpunim me qëllim të avancimit të bashkëpunimit në fushën e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar	Mitrovicë Veriore	Veri	4,010.00
Qendra për hapat rinor QeHR	Femra si shtyllë e fuqishme e shoqërisë dhe e familjes dhe fuqi punëtore e kualifikuar e cila ndikon në zhvillimin socio-ekonomik në shoqëri	Vushtrri	Veri	4,010.00
A vision for building a future		Mitrovicë Veriore	Veri	4,200.00
AZHR Perëndim	Ngritja e kapaciteteve në rajonin perëndimor për zbatimin e politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	Pejë	Perëndim	6,010.00
Agjencia për Zhvillim Rajonal Lindje - AZHR	Promovimi i turizmit në rajonin Lindje	Gjilan	Lindje	6,010.00
Qendra për rini të avancuar	Sipërmarrësit e rinj të komunës së Vushtrrisë	Vushtrri	Veri	4,005.00
Qendra për Edukim, Inovacion dhe Zhvillim Profesional AKADEMIA	Zhvillimi i shkathtësive të buta të rinjtë e komunës së Shtimes	Shtime	Jug-lindje	2,100.00
Agjencia për Zhvillim Rajonal Qendër - AZHR	Promovimi i politikave të zhvillimit të qëndrueshëm në fushën prodhimit në rajonin qendër	Prishtinë	Qendër	6,010.00
GLV Kalaja	Mbështetje e të rinjve të Komunës së Novobërdës, për zhvillimin e shkathtësive për qasje në tregun e punës	Novo Bërd	Lindje	6,010.00
Youth Education Center	Komuna dhe të rinjtë	Vushtrri	Veri	4,010.00
OMNES	Bashkëpunimi i të rinjve me ndërmarrësi për zhvillim të qëndrueshëm socio - ekonomik	Gjilan	Lindje	6,005.00
Center for Cooperation and Networking of Organization	Identifikimi dhe stimulimi i mundësive për bashkëpunim	Gjilan	Lindje	4,010.00
Kosova Genc Birlik Dernegi - KGBD	Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të nxënësve dhe mësuesve në arsimin para universitar në shkollën dhe menaxhimin e projekteve inovative	Prizren / Dragash	Jug	4,010.00
Asociacioni I gruas Feminae	Gruaja kosovare në aksion	Prizren	Jug	6,010.00
Practice Youth P.Y.	Ruralni Razvoj 2025	Prizren	Jug	4,010.00
Natural Fresh	Opste informacije o aplikantu , projektu i partnerina osnove informacije za organizaciju aplikanta i partnera	Prizren	Jug	4,010.00



Centar za afirmaciju mladih gracanica CZA	Mladi umetnici Web Dizajn i teknogjia	Gračanicë	Qendër	2,100.00
Centar za depolitizaciju kosovskog društva CDKD	Otoranje poslovanoh mogućnosti za zene kroz razvoj turizma u Regionu Genjilana	Kamenicë	Lindje	4,010.00
D&D Business Suport Center	Ngritja e kapaciteteve të rinjve në ndërmarrësi	Prishtinë	Qendër	3,600.00
Diagrami	Rritja e aftësive të buta të rinjtë - Inkurajimi për ngritjen e kapaciteteve në zhvillim socio- ekonomik rajonal	Mitrovicë	Veri	2,100.00
Kosovo Experts Group - KEG	Avancimi profesional dhe ngritja socio- ekonomike	Prishtinë	Qendër	2,200.00
Alternativa Rinore për Progres - ALRP	Të rinjtë dhe gratë me kapacitete të ngritura në fushën e zhvillimit socio ekonomik	Prishtinë	Qendër	3,600.00
Instituti për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë - IFPR		Prishtinë / Ferizaj	Qendër/ Jug-lindje	3,700.00
PONTIS/Ura	Zhvillimi i aftësive për udhëheqës komunitar në ndërmarrësi	Shtime	Jug-lindje	2,100.00
GLV Natyra	Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të komunave dhe shoqatave të biznesit dhe ofrimi i rekomandimeve për zhvillim të qëndrueshmërisë ekonomike të rajonit të Ferizajt	Shtime	Jug-lindje	3,500.00
Forumi Shqiptar i Diasporës	Fuqizimi i rolit të grave dhe të rinjve në ndërmarrësi	Suharekë	Jug	2,100.00
Qendra për Hulumtime dhe Politikë Gjinore - QHPGJ	Potenciali i grave dhe vajzave për një të ardhme të fuqishme.	Prishtinë	Qendër	3,500.00
Local Democratic Agency of Kosovo - LDA Kosovo	Projekti Internacional Display	Pejë	Perëndim	6,010.00
Research - RCH	Promovimi si mjet kyç për avancimin e qëndrueshmërisë socio-ekonomike	Prishtinë / Kamenicë	Qendër Lindje	4,010.00
Creative Center	Grua ekonomisht e fuqishme, grua e pavarur	Vushtrri	Veri	4,010.00
IDEA	Fuqizimi i të rinjve për ndërmarrësi dhe vetëpunësim	Prizren	Jug	4,010.00
EQUALITY	Unapredjenje socio-ekonomskog položaja zupe kroz promociju ruralnih kapaciteta: svi zaedno za zlata sela	Prizren	Jug	4,010.00
Progresi dhe Avancimi Rinor në Kosovë - PARKS	Prespektiva e përbashkë	Ferizaj	Jug-lindje	4,010.00
Instituti për Hulumtime dhe Analiza Sociologjike - IHAS - Sociometri	Avancimi i zhvillimit socio-ekonomik rajonal në Rajonin e Mitrovicës	Prishtinë	Qendër	4,010.00
Humanus Vita	Fuqizimi i grave ndërmarrëse në politikat e zhvillimit ekonomik.	Glogovc	Qendër	4,010.00
Bosnjacko Omladinski Klub - BOK	Mbështetje e të rinjve të Komunës së Novobërdës, për zhvillimin e shkathtësive për qasje në tregun e punës	Prizren	Jug	4,010.00
Tourism and Agriculture Development Fund TAD-F	Sveobuhvatni privredni razvoj Planine sar kroz kreiranje mreza inovatora poslovnih udruzenja, turistickih operatera I poljoprivrednih proizvodjaca	Shtërpcë	Jug-lindje	4,010.00
Global Development Solutions - GLOBEDS	Identifikimi dhe avancimi i ndërmarrësve socio- ekonomik	Prizren / Dragash	Jug	5,300.00



POLIS	Hartimi i projekteve propozimeve, biznes planeve për aplikim në institucionet vendore dhe ndërkombëtare, nga të rinjtë e Republikës së Kosovës	Mitrovicë	Veri	4,010.00
Qendra për edukim - Reforma	Zhvillimi socio-ekonomik në nivel lokal Komuna e Lipjanit	Lipjan	Qendër	4,010.00
Leadership Development Association Albania - LDAA	Promovimi i zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar në konferencën e LEAP-s	Ferizaj	Jug-lindje	6,010.00
POLITEIA	Komunat për bizneset drejt zhvillimit të qëndrueshëm	Viti	Lindje	4,010.00
Instituti për Ekonominë e Tregut të Lirë - IETL	Rritja e kapaciteteve për zyrtarët komunal: Trajnimi për menaxhimin efikas të projekteve	Prishtinë	Qendër	4,010.00
Iniciativa e Femrës Kosovare - IFK	Rritje dhe Barazi: Nxitje e zhvillimit socio-ekonomik rajonal	Gjakovë	Perëndim	6,010.00
Instituti 'IKSZQ'	Konferenca shkencore ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm rajonal	Prishtinë	Qendër	4,010.00
Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës	Promovimi i politikave të fushës së zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	Prishtinë	Qendër	4,010.00
Business Menagement Training Centre - BMTC	Avancimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio-ekonomik i grave në regjionin e Prishtinës	Prishtinë	Qendër	4,100.00
Tourism and Marketing Institute - TMI	Avancimi socio-ekonomik dhe zgjerimi i zhvillimit rajonal	Gjilan / Kamenicë	Lindje	2,200.00
Organizata Multietnike e Personave me Aftësi të Kufizuara - OMPAKL	Përkrahja e femrave me aftësi të kufizuara	Lipjan	Qendër	3,800.00
Center za mir i toleranciju - CMTP		Graçanicë	Qendër	4,010.00
Handikos - Lipjan		Lipjan	Qendër	3,800.00
IFYF		Fushë Kosovë	Qendër	2,010.00
GURMANIA		Fushë Kosovë / Obiliq	Qendër	4,010.00
Gjithsej:				244,700.00

(Burimi: DPKZHR – MZHR)

Shpërndarja rajonale dhe financiare:


Edhe pse thirrja publike nuk përcakton shpërndarjen e mjeteve sipas rajoneve zhvillimore, analizat tregojnë se pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile përfituese sipas rajoneve është si më poshtë:

- rajoni zhvillimor: Qendër ka pjesëmarrje 28%;
- rajoni zhvillimor: Jug ka pjesëmarrje 21%;
- rajoni zhvillimor: Veri ka pjesëmarrje 15%;
- rajoni zhvillimor: Lindje ka pjesëmarrje 13%,



- rajoni zhvillimor: Perëndim ka pjesëmarrje 5% dhe
- rajoni zhvillimor: Jug-lindje ka pjesëmarrje 11%.

Figura 1.: Shpërndarja e OSHC-ve përfituese sipas rajoneve zhvillimore



(Burimi: DPKZHR – MZHR)

Procesi i realizimit të pagesave ndaj OSHC-ve përfituese u ndan në dy faza:

- Në fazën e parë u bë pagesa e avancit, në masë prej 50% të vlerës së përgjithshme të mbështetjes financiare;
- Pjesa tjetër prej 50% u lëshua pas përfundimit të implementimit të projektit dhe dorëzimit të raportit financiar, i cili duhet të ishte i dokumentuar me faturat dhe dëshmitë përkatëse, pranë MZHR-së.

IV. NDIKIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK

Mbështetja financiare e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka pasur një rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik në rajonet e ndryshme të Kosovës. Përmes financimit të 61 projekteve të realizuara nga Organizatat e Shoqërisë Civile, është arritur të përkrahen iniciativa që kanë kontribuar në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të komuniteteve, sidomos atyre më të marginalizuara.

Rritja e kapaciteteve profesionale dhe ekonomike

Një nga ndikimet kryesore të mbështetjes financiare ka qenë fuqizimi i të rinjve dhe grave për të hyrë në tregun e punës dhe për të zhvilluar aftësi të nevojshme për ndërmarrësi. Projektet



që kanë përfshirë trajnime dhe përgatitje profesionale kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, duke rritur mundësitë për punësim të qëndrueshëm në nivel lokal.

Fuqizimi i komuniteteve dhe përfshirja sociale

Mbështetja financiare ka kontribuar në rritjen e përfshirjes sociale të grupeve të marginalizuara, si komunitetet: ashkali, rome dhe egjiptianë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara. Projektet kanë ndihmuar në zvogëlimin e pabarazive dhe në përmirësimin e aksesit të këtyre grupeve në shërbime dhe mundësi ekonomike, duke krijuar një shoqëri më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Zhvillimi i kapaciteteve lokale dhe bashkëpunimi rajonal

Financimi ka forcuar kapacitetet e organizatave lokale dhe rajonale në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore, duke rritur koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet akterve lokal. Kjo ka krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e politikave socio-ekonomike rajonale dhe për avancimin e strategjive për zhvillim të balancuar të rajoneve.

Efektet afatgjata dhe rekomandimet

Në përgjithësi, mbështetja financiare e MZHR-së ka luajtur një rol kyç në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të Kosovës, duke krijuar një ambient më të favorshëm për zhvillim ekonomik dhe përfshirje sociale. Për të rritur ndikimin e projekteve në të ardhmen, rekomandohet të vazhdohet përkrahja e kapaciteteve lokale dhe të forcohet monitorimi dhe raportimi për të garantuar efektivitetin dhe transparencën në përdorimin e fondeve publike.

V. REKOMANDIME

1. **Shpërndarja e financimit** - rekomandohet që në thirrjet e ardhshme të përcaktohet shpërndarja e mjeteve financiare në mënyrë më të balancuar midis rajoneve duke u bazuar në nevojat dhe kapacitetet lokale.
2. **Rritja e kapaciteteve monitoruese** - forcimi i stafit monitorues me më shumë burime dhe trajnime për të siguruar një mbikëqyrje më intensive dhe efektive.
3. **Raportimi i detajuar** - përfituesit të inkurajohen të dorëzojnë raporte të detajuara dhe të strukturuara mirë duke përfshirë dëshmi të aktiviteteve dhe rezultateve.
4. **Menaxhimi i rrezikut** - zbatimi i mekanizmave të parandalimit për vonesa dhe mosrealizime të aktiviteteve, duke përfshirë kontrole të rregullta të avancit.
5. **Fokus më i madh në bashkëpunim** - promovimi i iniciativave të përbashkëta ndërmjet OJQ-ve dhe aktorëve lokalë për të rritur ndikimin dhe qëndrueshmërinë e projekteve.

